

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i liderëve të UÇK-së/ Reagon Nik Gjeloshaj: Vendim jashtëzakonisht i padrejtë
ADRESA	https://dosja.al/politike/denimi-i-lidereve-te-uk-se-reagon-nik-gjeloshaj-vendim-jashtez-akonisht--i514488
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:02:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	00b247f2b3e4bc2f672cfa8719cc4fa744078b6744ec1b777a1b6439ebe5f836
TEKSTI	3aa31b2e4302341af1003c06af5c9ded361049cf62311cf7122100205f016e2a
PAMJA	3ec0071774cc4b0a947aa27dcaf41c4da368c297eb5501a2d2af814417bb0ac2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1731703e8a211186f105e77c9effe28ad9b45e85e43f3b86aaef0e1594d7e94a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1731703e8a211186f105e77c9effe28ad9b45e85e43f3b86aaef0e1594d7e94a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

5 ORE ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

9 ORE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

20 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

22 ORE ME PARE

108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen

Politike

Dënimi i liderëve të UÇK-së/ Reagon Nik Gjeloshaj: Vendim jashtëzakonisht i padrejtë

Sipas një reagimi të bërë publik në rrjetet sociale, Gjeloshaj e cilësoi vendimin si të padrejtë duke theksuar se bëhet fjalë për një vendim të shkallës së parë dhe se procesi gjyqësor vijon me të drejtën e ankimit.



16 Shtator 2026, 17:41
Nga G.M



Nik Gjeloshaj

MALI I ZI- Ish-kryetari i Komunës së Tuzit Nik Gjeloshaj, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Sipas një reagimi të bërë publik në rrjetet sociale, Gjeloshaj e cilësoi vendimin si të padrejtë duke theksuar se bëhet fjalë për një vendim të shkallës së parë dhe se procesi gjyqësor vijon me të drejtën e ankimit.

Në fjalën e tij, Gjeloshaj shprehu bindjen se në përfundim të procesit do të dëshmohej pafajësia e të akuzuarve. Ai e përshkroi luftën e UÇK-së si një luftë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe theksoi se ish-krerët e saj janë përballur me drejtësinë ndërkombëtare dhe do ta vijojnë betejën ligjore deri në fund.

"Lajm shumë i keq dhe një vendim jashtëzakonisht i padrejtë!"

Sot mund të jetë ditë zie për shqiptarët, por qëndrimi dinjitoz i të akuzuarve i jep forcë popullit shqiptar që ta përballojë këtë dhimbje, me besimin se ky aktgjykim i tmerrshëm do të rrëzohet në instancat më të larta.

Nuk kam besuar kurrë se një vendim gjyqësor mund të ishte i tillë dhe kaq i padrejtë. Ky është vendim i shkallës së parë dhe procesi gjyqësor nuk ka përfunduar. Besojmë se, deri në përfundimin e plotë të procesit, do të dëshmohej pafajësia e të gjithëve.

Lufta e UÇK-së ishte vetëmbrojtëse, çlirimtare dhe e drejtë. Ishte luftë për mbijetesën, lirinë dhe shtetin e Kosovës, e përkrahur nga aleatët tanë perëndimorë. Agresori nuk mund dhe nuk duhet të barazohet me atë që është detyruar të mbrohet.

Shqiptarët dhe vetë të akuzuarit i kanë respektuar institucionet ndërkombëtare. Ata as nuk kanë ikur, as nuk janë

editoriale

Irena Begiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 16:18

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46

DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

fshehur, por janë paraqitur para drejtësisë dhe do ta vazhdojnë betejën e tyre ligjore deri në fund.

Çdo shqiptar e ka në zemër luftën e shenjtë të UÇK-së dhe komandantin legjendar Adem Jashari. Çdo shqiptar beson në pafajësinë e tyre! Liria dhe pavarësia kanë një vullë: UÇK-ja dhe Amerika!

RS.

Nuk ia vlen të komentohet nxjerrja e një deklarate sime nga konteksti dhe manipulimi me të. Biseda ishte për respektimin e vendimeve të gjykatave ndërkombëtare nga shqiptarët, për dallim nga qëndrimi i palës tjetër. Kurrë nuk kam besuar se gjykatat ndërkombëtare mund të bëjnë padrejtësi.

Edhe Ante Gotovina përjetoi padrejtësi në shkallën e parë, por në shkallën e dytë fitoi drejtësi. Besojmë deri në fund; beteja për drejtësi vazhdon", u shpreh Nik Gjeloshaj./Dosja.al

nik gjeloshaj

uçk

Sondazh

Poll

Politike

16 Shtator 2026, 17:30

Dënimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë/ Reagon Marta Kos: Vendimet e Gjykatës duhet të respektohen, bëhet fjalë për përgjegjësi individuale

Marta Kos BRUKSEL- Komisionerja evropiane për Zgjerimin Marta Kos, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Kosov&eu...

"Marre"/ Pas dënimit të Thaçit, Ramën e masakrojnë komentuesit në rrjetet sociale: Dikur udhëtove me helikopter për t'i bërë presin të votojë pro krijimit të Speciales

Politike

16 Shtator 2026, 17:26

Vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë: Historia e Kosovës nuk rishkruhet

Politike

16 Shtator 2026, 17:19

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:40

"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët"/ Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi

më të klikuarat

Përgjimet dhe akuzat për tregti armësh, reagon kompania ku u përgjuan: Ron Yeffet nuk na përfaqëson, përgjimi ishte i paautorizuar

Daja i saj përdhunoi 34-vjeçaren, reagon Zegjine Çaushi: Më thanë se do martohen

Kongresmeni Wilson: Qeveria e Ramës po nxit trafikun e narkotikëve. Zv/ndihmës Sekretari Lawton: Organizatat kriminale kanë lidhje me kartelet këtu në SHBA

"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ The New Yorker: Si u hapën dyert për Jared Kushner

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by  tomorrow.

"Viktima të krimeve të rënda nga regjimi i Milleshoviçit"/ Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Kroacia: Vendimi i Hagës nuk ndryshon kontekstin e luftës në Kosovë

Politike

16 Shtator 2026, 17:04

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro

Politike

16 Shtator 2026, 16:18

Politike

16 Shtator 2026, 16:46

Vendimi i Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Mbretëria e Bashkuar: Reagimi të jetë paqësor, të mos nxis tensione

Flamuri i Mbretërisë së Bashkuar BRITANI E MADHE- Mbretëria e Bashkuar ka reaguar pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara...

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi i Shqipërisë të miratojë Rezolutë për dënimin e genocidit serb në Kosovë

Politike

16 Shtator 2026, 15:54

"U shpërfill konsultimi institucional"/ Pagat e magjistratëve, Gjykata e Lartë kundër projektligjit të PS: Parlamenti të mos e miratojë

Politike

16 Shtator 2026, 15:40

Dënimi i ish-krerëve të UÇK/ DASH-

Shmangni retorikën nxitëse, punoni për një të ardhme paqësore

Politike


16 Shtator 2020, 15:36

Berisha: Përplasjet e fundit me sistemin e drejtësisë dëshmojnë se kemi të bëjmë me një shtet bandit

Politike

16 Shtator 2020, 14:39

MË SHUMË



Pamje prekëse nga Prishtina/ Polici shpërthen në lot kur protestuesit i vendosin pranë flamurit

Haga dënon ish krerët e UÇK-së me 81 vite burg, vogëlushi shpërthen në lot

Haga e dënoi me 25 vite burg, ja si e prit Hashim Thaçi vendimin

Haga dënon ish- krerët e UÇK-së me 81 vite burg, shqiptarët përplasen me policinë pas vendimit

Pamje prekëse nga Prishtina/ Polici shpërthen në lot kur protestuesit i vendosin pranë flamurit

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MBULIMET NGA SIGA Mediasdek

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.